

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaRep® Cosmetic

LLAÇ KOZMETIK ME BAZË ÇIMENTOJE, AGREGATE DHE RRËSHIRA SINTETIKE

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaRep® Cosmetic është llaç kozmetik riparimi sipërfaqësor me 1 përbërës, me bazë çimentoje, agregate të imëta dhe i përforcuar me rrëshira sintetike, të cilat aplikohen në një shtresë të hollë.

PËRDORIMET

Është i përshtatshëm për aplikim mbi beton, llaç ose gur në rastet e mëposhtme:

Si llaç riparues kozmetik për trajtimin e defekteve:

- Shkëputjen e grautit nga sipërfaqja si pasojë e gërvishtjes.
 - Porozitetin, parregullsitë e vogla, zgavrat.
 - Skajet/ qoshet e thyera
 - Plasaritje të vogla
- Si një llaç nivelues:
- Për elemente të parafabrikuara
 - Për përgatitje suvaje
 - Për nënshtresa të paniveluara përpara shtrimit të pllakave qeramike

Si llaç për:

- Për izolimin e fugave të vogla pa lëvizje
- Për mbushjen e hapësirave të vogla që lëjnë kutitë e prizave, ankorimet, fiksimet, gozhdët tek betoni.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Ndërkapje e mirë mbi nënshtresë
- Lehtësi në fillimin e punës
- Konsistencë e adaptueshme gjatë procesit të punës
- Ngurtësim pa plasaritje
- Rezistencë ndaj ujit dhe kushteve të motit
- Formon një sipërfaqe shumë të lëmuar
- Mund të lyhet

MIRATIME / STANDARDE

Llaç suvatimi për përdorim të jashtëm sipas UNE-EN 998-1: 2010 deklaratë performance 01 03 02 04 003 0 000101 1053 dhe mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Llaç me bazë çimentoje i përforcuar me rrëshira sintetike
Ambalazhi	thes 23 Kg
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur ngjyrë gri e lehtë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Në ambalazhin origjinal dhe të padëmtuar, në vend të freskët dhe të thatë dhe i mbrojtur nga ngrica.
Dendësia	Dendësia e llaçit të freskët: 1,9 kg/l
Përmasa maksimale e kokrrizës	~ 0-0.3 mm (EN 12192-1)

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	7 ditë	26,9 N/mm ²
	28 ditë	30,9 N/mm ²
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	7 ditë	3.9 N/mm ²
	28 ditë	6 N/mm ²
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	7 ditë	1,48 N/mm ²
	28 ditë	1,64 N/mm ²

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	~ 1.9 kg / m ² / mm miks i thatë dhe ~ 1.63 kg / m ² / mm SikaRep® Cosmetic Konsumimi minimal për shtresë është 0.9 kg / m ² me trashësi 0.5 mm.
Trashësia e shtresës	min. 0,5 mm / max. 2 mm.
Temperatura e mjedisit	min. +5°C / max. +30°C
Temperatura e nënshtresës	min. +5°C / max. +30°C
Koha e aplikimit	Kur i gjithë Sika Rep® Cosmetic të jetë shtuar tek uji, përzieni për 2-3 minuta derisa të përftohet një masë homogjene.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Cilësia e nënshtresës

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme, e pastër, e thatë, pa vaj dhe graso, pa pluhur, ujë të grumbulluar dhe materiale të shpërbëra.

Përgatitja e nënshtresës

Nëse nevojitet, nënshtresa preferohet të pastrohet me mjete mekanike.

Nënshtresat absorbuere lagen paraprakisht deri në saturim, por duhet të shmangët uji i mbledhur. Filloni aplikimin e SikaRep® Cosmetic kur sipërfaqja të ketë një pamje mat të errët.

PËRZIERJA

~ 5.3 l ujë për thes SikaRep® Cosmetic

Hidhni brenda një ene të përshtatshme sasinë e kërkuar të ujit duke shtuar gradualisht SikaRep® Cosmetic

Konsistenca e dëshiruar mund të përftohet duke ndryshuar raportet e përzierjes, të cilat mund të ndryshojnë gjithashtu sipas kushteve të mjedisit. Nëse gjatë aplikimit pakësohet punueshmëria e miksit dhe fillon të trashet, thjesht përzieni sërish pa shtuar ujë, për të rikuperuar një pjesë të punueshmërisë fillestare.

METODA E MATURIMIT

Mbroni llaçin e freskët nga dehidratimi i hershëm duke përdorur metodën përkatëse të maturimit.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
SikaRep® Cosmetic
Qershor 2019, Botimi 01.01
020302040030000101

SikaRepCosmetic-sq-AL-(06-2019)-1-1.pdf

